

VENDIM
Nr. 72, datë 6.2.2026

**PËR MIRATIMIN E BUXHETIT PËR AGJENCINË E ZHVILLIMIT TË
TERRITORIT PËR VITIN 2026**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 7/1, të ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin territorit”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e buxhetit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit për vitin 2026, sipas shtojcës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 2. Të ardhurat e krijuara nga Agjencia deri në fund të vitit 2025 trashëgohen në vitin buxhetor 2026 dhe përdoren nga Agjencia për mbulimin e kostove e të shpenzimeve të veta.
 3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2026.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA NR.1

PEMA E PROGRAMIT TË AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT PËR VITIN 2026

Qëllimi i programit

Agjencia e Zhvillimit të Territorit ka për qëllim mbështetjen dhe zbatimin e proceseve të zhvillimit dhe kontrollit të territorit në nivel kombëtar, duke ushtruar funksionet e sekretariatit teknik të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit. Ajo administron, koordinon dhe monitoron proceset e zhvillimit të territorit, lejeve dhe zbatimit të vendimeve përkatëse, siguron funksionimin e sistemit elektronik të lejeve, si dhe siguron bashkëpunim ndërinstytucional dhe transparencë në shërbim të zhvillimit të qëndrueshëm të territorit.

Objektivat

1-Zbatimi dhe koordinimi efektiv i politikave të zhvillimit të territorit përmes ushtrimit të funksioneve të sekretariatit teknik të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit dhe monitorimit në kohë reale të proceseve ndërtimore, në përputhje me lejet e lëshuara, duke garantuar zbatimin e vendimeve, në përputhje me projektin e miratuar dhe legjislacionin në fuqi.

2- Rritja e eficiencës institucionale dhe cilësisë së shërbimeve përmes dixhitalizimit të proceseve, bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstytucional dhe përmirësimi i sisemit elektronik e-Leje.

3-Administrim dhe menaxhim i qëndrueshëm i të ardhurave institucionale, duke siguruar planifikim, monitorim dhe arkëtim korrekt të të ardhurave që burojnë nga proceset e lejeve dhe shërbimeve të lidhura me zhvillimin e territorit.

4- Unifikimi i procedurave dhe dokumentacionit ligjor nëpërmjet hartimit të një manuali të unifikuar për të thjeshtuar procedurën për aplikuesit, si dhe optimizimin e proceseve të brendshme të shqyrtimit të aplikimeve, me qëllim shkurtimin e kohës së trajtimit të aplikimeve.

OBJEKTIV 1

Prod 1: Monitorim i territorit dhe parandalimi i tejkalimit të lejeve të ndërtimit, duke garantuar zbatimin e vendimeve, në përputhje me projektin e miratuar dhe legjislacionin në fuqi.

OBJEKTIV 2

Prod 2: Rritja e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstytucional, si dhe optimizimi i vazhdueshëm i sistemit e-eleje.

OBJEKTIV 3

Prod 3: Përmirësim i procedurave të brendshme për menaxhimin financiar dhe arkëtimin

OBJEKTIV 4

Prod 4: Hartimi i një manuali të unifikuar për të thjeshtuar procedurën për aplikuesit, si dhe për të optimizuar proceset e brendshme të shqyrtimit të aplikimeve

BUXHETI I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT 2026

	BUXHETI 2026	
PËRSHKRIMI	Të ardhurat	Shpenzimet
Të ardhura nga veprimtaria ose nga tarifat e shërbimeve	3 500 000 000	
Të ardhura të mbartura të vitit 2025	2 812 616 921	
Shpenzime për pagat e punonjësve organikë		290 000 000
Shpenzimet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore		35 000 000
Fond i veçantë		14 500 000
Shpenzime korrente të tjera		60 000 000
Shpenzime për aktivitete, konkurse, ndërkombëtare, aktivitete etj.		200 000 000
Shpenzime kapitale		35 000 000
Total AZHT	6 312 616 921	634 500 000
Teprica e të ardhurave	5 678 116 921	

BUXHETI I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT 2026**LEKË**

Nr.	EMËRTIMI	BUXHETI 2026
I	TOTALI I TË ARDHURAVE	2 812 616 921
2	Të ardhura të akumuluar	2 812 616 921
II	TOTALI I SHPENZIMEVE	634 500 000
1	Shpenzime personeli	339 500 000
1	Pagat e punonjësve	290 000 000
2	Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	35 000 000
3	Fond i veçantë	14 500 000
2	Shpenzime operative	260 000 000
1	Shpenzime për materiale, shërbime dhe të tjera operative	60 000 000
2	Shpenzime për aktivitete, konkurse ndërkombëtare, aktivitete etj.	200 000 000
3	Shpenzime kapitale	35 000 000
1	Blerje autoveturë	5 000 000
2	Blerje pajisje për mobilim	5 000 000
3	Shpenzime për objekte specifike	10 000 000
4	Blerje pajisje kompjuterike	15 000 000